

## **SHPALLJE PER APLIKACIONE**

### ***PILOT-PROJEKTI I KULMEVE SOLARE***

Për bizneset dhe shtëpitë rezidenciale, faturat e energjisë elektrike mund të jenë pjesë e madhe e shpenzimeve mujore. Investimi në energji solare në Kosovë është tashmë i arritshëm, si dhe ide e shkëlqyeshme. Sistemet e energjisë elektrike nga dielli prodhojnë energji të pastër elektrike me anë të dritës së diellit, duke zvogëluar faturat elektrike dhe duke ulur ndikimin mbi mjedis.

Për të promovuar instalimin dhe përdorimin e paneleve solare në biznese të vogla dhe shtëpitë rezidenciale, EMPOWER Sektori Privat dhe kompania Jaha Solar janë duke bashkëpunuar dhe duke bashkëfinancuar iniciativën e Pilot-Projektit për Panele Solare. Bizneset e vogla dhe shtëpitë rezidenciale që kanë interesim për të instaluar panele solare fotovoltaike inkurajohen të aplikojnë për të marrë pjesë në projekt (sipas udhëzimeve më poshtë). Përmes kësaj iniciative me pilot-projekt, deri në 30% të koston së përgjithshme investuese do të subvencionohet nga Projekti EMPOWER dhe Jaha Solar, për kapacitete prej 9-20kW për biznese të vogla dhe 2-5kW për shtëpitë rezidenciale. Kthimi mbi investime për bizneset e vogla që instalojnë panele solare fotovoltaike kalkulohet të jetë rreth pesë vjet për grupin tarifor 4(7/01 dhe 7/02),<sup>1</sup> dhe afërsisht gjashtë vjet për grupin tarifor 3(6/6), ndërsa për shtëpitë rezidenciale koha e kthimit të investimeve pritet të jetë më e lartë për shkak të sistemit të depozitimit – baterive.

#### **1. Sfondi**

Qëllimi i këtij projekti është të nxisë shitjen dhe krijimin e vendeve të punës në bizneset e sektorit të energjisë së ripërtërishme, si dhe të promovojë shfrytëzimin e energjisë së ripërtërishme për zbutjen e ndryshimeve klimatike globale. Ky bashkëpunim synon të nxisë një fond të përbashkët me banka/qeveri/ndërmartje për të financuar koston fillestare të instalimit të sistemeve solare shumë më gjerësisht.

Projekti EMPOWER Sektori Privat është projekt pesëvjeçar që ka filluar në korrikun e vitit 2014 për të mbështetur rritjen e qëndrueshme ekonomike, zgjerimin e punësimit, si dhe rritjen e të ardhurave familjare në Kosovë. Ai implementohet nga Cardno me kontratë nga USAID-i, në partneritet me SIDA-n. Projekti EMPOWER Sektori Privat është hartuar për të stimuluar krijimin e vendeve të punës në masë të gjerë përmes firmave individuale, derisa ato vetë zgjerojnë bizneset e veta. Projekti punon ngushtë me firma dhe individë nga sektorët me potencial të rritjes, për t'i ndihmuar ato që të identifikojnë dhe të ndërlihen me mundësitë e tregut, të rrisin prodhimtarinë, të avancojnë aftësitë menaxhuese dhe të fuqisë punëtore, si dhe të përmirësojnë qasjes në financa. Energjia është njëri prej sektorëve të fokusimit të projektit Empower Sektori Privat.

Jaha Solar është i vetmi prodhues i paneleve solare fotovoltaike në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Prodhimi testues ka filluar në prill të vitit 2016, ndërsa produkti për herë të parë iu prezantua publikut në Festivalin e Gjellbër të organizuar nga EMPOWER, në maj të vitit 2016. Jaha Solar zyrtarisht hapi fabrikën e prodhimit në qershor të vitit 2016.

---

<sup>1</sup> Grupi tarifor 4(7/01 dhe 7/02) dhe grupi tarifor 3(6/6) paraqesin grupin tarifor qe paguajnë tarifën më të lartë të rrymës.

## 2. Mbështetja financiare, çmimet dhe kapacitetet e përgjithshme në kW

Empower dhe Jaha Solar bashkërisht kanë zotuar 136,125 Euro për të financuar instalimin e kapaciteteve rreth 425kW në sisteme të plota të paneleve solare, prej të cilave 350kW do të jenë për biznese të vogla, ndërsa 75kW për shtëpitë rezidenciale. Në tabelën e mëposhtme, mund të shihni çmimet e tregut për kW dhe çmimet e subvencionuara për kW.

	<b>Bizneset</b>	<b>Shtëpitë rezidenciale/me bateri</b>
Çmimi i rregullt për kW (pa TVSH)	€ 1,035	€ 1,635
Kostoja e subvencionuar e përfituesit për kW (pa TVSH)	€ 750	€ 1,150

Si rezultat i subvencioneve, bizneset e vogla përfituese do të paguajnë vetëm 750 EUR (pa TVSH) për kW, ndërsa shtëpitë rezidenciale do të paguajnë vetëm 1,150 Euro për kW (pa TVSH) (kostoja është më e lartë për shtëpitë rezidenciale, pasi që përfshin edhe baterinë akumuluese).

## 3. Aplikuesit e mundshëm dhe kriteret

Aplikues të mundshëm janë:

- **Bizneset e vogla** që paguajnë çmimin/tarifën më të lartë të energjisë elektrike (grupi tarifor 4(7/01 dhe 7/02) dhe grupi tarifor 3(6/6)), si dhe përmbushin kriteret vijuese të pranueshmërisë:
  - Duhet të jenë në gjendje të financojnë blerjen e panelit solar (ju lutemi t'i referoheni tabelës si më lart për çmimet e subvencionuara për kW)
  - Të kenë së paku 1,000 Euro në fatura mujore të energjisë elektrike (duhet të ofroni kopje të së paku 3 faturave mujore elektrike të pranuar brenda një viti, në pragun prej së paku 1,000 Euro)
  - Të kenë së paku 120 m<sup>2</sup> hapësirë kulmi në dispozicion për instalim të paneleve solare
  - Sipërfaqja e kulmit preferohet të jetë e orientuar kah jugu.
- **Shtëpitë rezidenciale** nga zonat rurale (ata që përballen me më së shumti ndërprerje të energjisë do të kenë përparësi)
  - Duhet të jenë të gatshëm të financojnë blerjen e panelit solar (ju lutemi t'i referoheni tabelës si më lart për çmimet e subvencionuara për kW)
  - Të kenë së paku 20 m<sup>2</sup> sipërfaqe kulmi në dispozicion për instalimin e panelit solar.
  - Sipërfaqja e kulmit preferohet të jetë e orientuar kah jugu.

**Të gjithë aplikuesit e interesuar duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, që mund të shkarkohet nga faqja jonë e internetit [www.empowerkosovo.org](http://www.empowerkosovo.org), si dhe ta dërgojnë tek adresa [saf@Empowerkosovo.org](mailto:saf@Empowerkosovo.org) deri më 13 qershor 2017. Te gjitha pyetjet lidhurë me këtë aplikim duhet të dërgohen me e-mail në adresën [saf@empowerkosovo.org](mailto:saf@empowerkosovo.org) deri më 31 maj 2017.**